**VENDIM**
**Nr. 324, datë 29.5.2024**

## PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË INTEGRUAR TË VEPRIMTARIVE, NË KUADËR TË VITIT MBARËKOMBËTAR TË 80-VJETORIT TË ÇLIRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 6, të vendimit nr. 32, datë 17.1.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e vitit 2024 'Viti mbarëkombëtar i 80-vjetorit të Çlirimit' dhe krijimin e komisionit shtetëror për organizimin e veprimtarive në kuadër të tij", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalendarit të integruar të veprimtarive në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të 80-Vjetorit të Çlirimit, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në buxhetin e miratuar për vitin 2024, nga fondi rezervë i buxhetit, u shtohen fonde për zhvillimin e disa aktiviteteve, sipas përcaktimeve të lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, si më poshtë:

a) Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i shtohet fondi prej 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekësh në programin "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", në llogarinë ekonomike 602;

b) Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit i shtohet fondi prej 17 720 000 (shtatëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet mijë) lekësh në programin "Arti dhe kultura", fonde korrente në llogarinë ekonomike 604.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga ky vendim, me përjashtim të atyre të përmendura në pikën 2, të këtij vendimi, që përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për çdo institucion.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Biblioteka Kombëtare dhe Policia e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**LIDHJA 1**

| Nr | Emri i Aktivitetit | Përshkrimi i Aktivitetit | Institucioni propozues | Në bashkëpunim me | Periudha e realizimit | Burimi i financimit | Kostot e përafërta (në lekë) | Nga fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Shfaqje filmash dhe diskutim mbi problematikat që trajtojnë veprat kinematografike te shfaqura | Dallimet që na bashkojnë do të jetë tema e aktivitetit një bashkëpunim mes AQSHF dhe Kinotekës së RMV në Shkup ku do të shfaqen filmat Lulëkuqet mbi mure (Anagnosti 1976) dhe Uji i madh (Ivo Trajkov 2003) si dhe do të ketë diskutime mbi këto dy vepra kinematografike. Problematikat që trajtohen në këto filma kanë shumë pika të përbashkëta (tek dy filmat në spikamë janë fëmijët në jetimore, indoktrinimi në idelogjitë e kohës dhe lufta për liri etj) | Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit | Shkup, RMV | 25.04.2024 | Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit | - | - |
| 2 | Konferencë Kombëtare për rëndësinë e historisë në kontekste të reja<br>80-vjetori i Çlirimit dhe historia | Konferencë kombëtare me historianë, profesorë, akademikë qe do të jenë të pranishëm në këtë ngjarje, e cila kërkon të rikthejë në diskursin publik rëndësinë e historisë në kontekste të reja shoqërore e kulturore dhe rolin e së shkuarës. | QKLL | Ak Shkencave SHQ-KS | 27.04.2024 | QKLL | - | |
| 4 | Konkurs letrar për 'Novelat Grafike' mbi clirimin shqiptar. | Konkursi letrar për autorë të rinj "Novelat Grafike" bazuar mbi temen e clirimit shqiptar | MEKI | MEKI | 01.05.2024 | MEKI | - | |
| 5 | Dita e koleksioneve 'Collection DAY' te kujtimeve dhe suvenireve nga lufta | Aktivitete ku nxenesit mbledhin kujtime, suvenire qe lidhen me luften | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP, IA | 01.05.2024 | MAS | - | |
| 6 | Kampionate sportive për Kupën '80 Vjetori i Çlirimit' në futboll, volejboll, dhe basketboll. | DRAP/ZVAP/DPAP organozojnë kampionate në futboll, volejboll, basketboll për kupën "80 Vjetori i Çlirimit". | Ministria e Arsimit dhe Sportit | KOKSH, DPAP | 01.05.2024 | MAS | - | |
| 7 | Memoriali për Dëshmorët e Policisë në 5 Maj: Ceremoni, Takime, dhe Koordinim me pushtetin vendor per restaurimin e varrezave. | Organizimi i ceremonive, takim përkujtimor, vendosje kurorash, nga çdo strukturë qendrore dhe vendore në përkujtim të Dëshmorëve.<br>Realizmi i vizitave në familjet e Dëshmorëve të Policisë<br>Koordinimi me institucionet e pushtetit vendor për restaurimin e varrezave apo memorialeve kushtuar Dëshmorëve të Policisë | Policia e Shtetit | Drejtoritë Vendore të Policisë<br>Pushteti Vendor | 05.05.2024 | Policia e Shtetit | 200,000 | |
| 8 | Bibliotekë e hapur me materiale të lexueshme, shoqëruar me instalacione të foto dhe video dokumentare. | Biblioteka hapet në një ekspozitë , ku gazeta ose libra që flasin per kete teme, te jete e vendosur per t'u lexuar e parë nga publiku, ne tavolina te medha te përbashkëta, shoqëruar me foto dhe video dokumentarë si instalacione. | BK | BK | 20.05.2024 | BK | - | |
| 9 | Shkrimtarët e luftës; Aktivitete për të rikthyer autorët dhe veprat e tyre per luften në vëmendje, duke përfshirë edhe emra të letërsisë bashkëkohore. | Një cikël aktivitetesh me në fokus shkrimtarë që kanë shkruar një vepër kushtuar Luftës së Dytë Botërore dhe rolit të Shqipërisë në këtë tablo historike. Përmes aktiviteteve të dedikuara do të rikthehen në vëmendje autorë që nuk jetojnë më, por që i kanë kushtuar një pjesë të veprimtarisë së tyre luftës, por dhe emra të letërsisë bashkëkohore që në artin e tyre janë grishur nga historia.<br>Ky cikël aktivitetesh kërkon ta sjellë temën e luftës në këtë 80-vjetor në diskursin publik. | QKLL | MEKI | 25.05.2024 | QKLL | - | |
| 10 | Gratë e Trashëgimisë: Evidentimi i Kontributit të personaliteteve femërore Pas Luftës së Dytë Botërore | Evidentimi i personaliteteve femërore me kontribut pas Luftës II Botërore në fushën e trashëgimisë kulturore; drejtueset e misioneve arkeologjike femra në qendrat kryesore, si Aleksandra Mano, Hëna Spahiu (Koman, Berat, etj) dhe në fushën e studimit të monumenteve të kulturës, si Viktori Puzanova, Dhorka Dhamo, në pikturë murale, Fatbardha Shkupi në skulptura dekorative në dru, etj. Aktiviteti mund të përmbajë fotografi të vjetra gjatë punës në terren, përmbledhje të studimeve, etj. | IKTK | MEKI | 28.05.2024 | IKTK | - | |
| 11 | Video e animuar për fëmijë me personazhe model frymëzimi dhe histori që transmetojnë vlerat e guximit, sakrificës, dashurisë për atdheun, lirisë dhe paqes. | Përfshirja e historisë në një mënyrë që është e kuptueshme për fëmijët, duke përdorur personazhe dhe histori që transmetojnë vlerat e guximit, sakrificës dhe dashurisë për atdheun.<br>Krijimi i personazheve të animuar që përfaqësojnë luftëtarët e lirisë, të cilët fëmijët mund t'i shohin si modele frymëzimi.<br>Nëpërmjet historisë, të transmetohen mesazhe rreth rëndësisë së paqes, lirisë, dhe rëndësisë së bashkëpunimit për të arritur qëllime të mëdha. | MSHRF,MEKI | MEKI | 01.06.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit , implementohet nga MEKI | 510,000 | 510,000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 12 | Organizimi i Konferencës 8-të Shkencore Mbarëkombëtare Arkivore në Elbasan: Sesion Shkencor për LANÇl. | Pranimi abstrakteve, vleresimi tyre.Pritja e pjesemarresve. Zhvillimi I Konferences ne qytetin e Elbasanit | Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave | DPA, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Bashkia Elbasan, studiues, historianë | 08.06.2024 | DPA | - | |
| 13 | Bashkëpunimi DoArt dhe AQSHF në Festivalin e 6-të të Artistëve të Rrugës | Në edicionin e 6 të Tirana Street Artists Festival organizuar nga qendra kulturore DoArt, AQSHF do të bashkëpunojë me shfaqjen e filmave me temë nga lufta dhe krijimeve kreative me artistët e rrugës, të frymëzuara nga tematika e heroit që lufton për liri. | Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit | Bashkia Gjirokastër | 15.06.2024 | ivi Qendror Shtetëror i Fil | - | |
| 14 | Iniciativa për Trashëgiminë e Luftëtarëve të Çlirimit të Shqipërisë: Projekte Vullnetarizmi Komunitar | Projekte vullnetarizmi ose iniciativa shërbimi ndaj qytetarëve, në nderim të trashëgimisë së atyre që luftuan për çlirimin e Shqipërisë. Këto iniciativa mund të përfshijnë aktivitete, si pastrimi i vendeve historike ose pjesëmarrja në ceremoni kujtimore, etj. | Ministria e Brendshme | | 01.07.2024 | Ministria e Brendshme | - | |
| 15 | Fushata në mediat sociale për 80-vjetorin e çlirimit | Përdorim platformat e mediave sociale për të ndarë fakte historike, histori personale dhe mesazhe kujtimore lidhur me 80-vjetorin e çlirimit, duke angazhuar publikun dhe nxitur një ndjenjë krenarie dhe uniteti kombëtar. | Ministria e Brendshme | | 01.07.2024 | Ministria e Brendshme | - | |
| 16 | Ceremoni për Vendosjen e Eshtrave të Dëshmorëve të Policisë në Varrezat e Atdheut dhe Koordinimi për Vendosjen e Eshtrave të Dëshmorëve të Tjerë Policë. | Organizimi I Ceremonive për t'u vendosur në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut eshtrat e 6 Dëshmorëve nga radhët e Policisë së Shtetit, 5 nga Qarku Tiranë dhe 1 nga Qarku Durrës, te miratuar nga Komisioni Qendror<br>Koordinimi me institucionet përkatese që edhe Dëshmorët e tjerë nga radhët e policisë të prehen tek varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. | Policia e Shtetit | Komisionin Qendror, Bashkia Tiranë dhe Institucionet e Varësisë, Prefekti i Qarkut Durrës dhe Bashkia, Institucionet vendore në çdo qark | 01.07.2024 | Policia e Shtetit | 1,200,000 | |
| 17 | Ekspozitë e Monumenteve të Dëmtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, Shoqëruar nga Fotografi të Vjetra dhe Materiale Arkivore | Manastiri I 40 Martireve te Sebastes, Xhamia e Sulejman Pashe Bargjinit ne TiraneE gjithë ekspozita do shoqërohet nga imazhe, fotografi të vjetra, materiale grafike dhe arkivore, tekste përshkruese, të cilat do të pasqyrojnë historikun dhe vlerat e tyre | IKTK | MEKI | 01.07.2024 | IKTK | - | |
| 18 | Intervista dhe biseda me shkrimtarë, historianë dhe veteranë të LANÇL | Shkollat organizojnë biseda me shkrimtarë, historianë dhe veteranë të LANÇL, në data të shënuara si 9 maj dhe në festat e nëntorit. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP | 01.08.2024 | MAS | - | |
| 19 | Gusht e n'Fest<br>shfaqje dhe performanca<br>DoArt dhe AQSHF | AQSHF do të bashkëpunojë me DoArt për të shfaqur filma me tematikën e luftës në aktivitetin Gusht e n'Fest, që zhvillohet cdo muaj gusht në Gramsh, Elbasan. | Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit | Bashkia Gramsh | 01.08.2024 | ivi Qendror Shtetëror i Fil | - | |
| 20 | Ekspozite me fotografi dhe piktura nga fonde artistike private te familjeve | Ministria e Mbrotjes do te organizoje nje ekspozite me foto dhe piktura me tematike lufte nga fonde private te familjeve patriotike ne vend. | Ministria e Mbrojtjes | QKMB, DPA | 01.09.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 830,000 | |
| 21 | Drama - Vënie në skenë teatrore (lëvizëse) | "20 ditë" dramë nga Fadil Paçrami<br>"Familja e peshkatarit" - Sulejman Pitarka<br>"Hijet e natës" - Vedat Kokona | Ministria e Mbrojtjes | Qendër Qark | 01.09.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 5,400,000 | |
| 22 | 55 Vjetori I titullimit "Oficere" të grave të Ushtrisë Shqiptare | Grupi i punës nga QKMBMMFA do të merret me organizimin e aktivitetit si mirënjohje pë r kontributin e dhënë gjatë viteve. | Ministria e Mbrojtjes | Qendra Kulturore e Fa | 01.09.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 280,000 | |
| 23 | Podcast me tematikë nga ngjarje e data të shënuara të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare | Evidentimi I personave<br>Përgatitja e tekstit (pyetësori) Montimi materialit<br>Shfaqja e materialit në mjetet e komunikimit të DPA | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave,MM | MM,Akademikë, Studiues, historianë, arkivistë | 01.09.2024 | DPA | - | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 24 | Evente rinore me kenge patriotike te remiksuara, në 6 qytete | Dj bashkekohore ne kala apo sheshe të qyteteve te tjera , kod veshjesh dhe pijesh per ta sjelle tek te rinjte proven e historise artistike qe ka lene ajo kohe ne nje format me prane kohes.Tiranë, Korçë, Vlorë, Gjirokastër, Berat, Shkodër. | MEKI/MM | Pushteti vendor | 01.09.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit, implementon MEKI | 3,018,000 | 3,018,000 |
| 25 | Ekspozitë e hapur: Muaji i Monumenteve Historike | Të gjitha monumentet historike do të jenë të aksesueshme për publikun njëkohësisht<br>· Përshkrime, materiale grafike dhe fotografike, vendosje në plan, përshkrime të historikut të tyre, së bashku me një hyrje të përgjithshme historike rreth periudhës | IKTK | MEKI | 01.09.2024 | IKTK | - | |
| 26 | Vizita në muze dhe në vendet e kujtesës së të rënve për atdhe | Oganizimi i vizitave me nxënësit në muze dhe në vendet e kujtesës së të rënve për atdhe, sipas kalendarëve të përcaktuar në bazë shkolle dhe ZVAP-je. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP | 01.09.2024 | MAS | - | |
| 27 | Koncert me këngë partizane QKMBMMFA dhe AQSHF | Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut të Forcave të Armatosura do të shfaqin një koncert me këngë partizane të mbledhura dhe redaktuara nga Baki Kongoli dhe muzikën e filmave me temë nga lufta, të performuar nga Ansambli i FA. | Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit | Bahkia Tiranë | 23.09.2024 | ivi Qendror Shtetëror i Fil | - | |
| 28 | Shfaqja dhe diskutimi i dokumentarëve, filmave me temë nga Lufta e II Botërore në kuadër të datave të shënuara historike. | Në kuadër të datave të shënuara historike në shkolla do të organizohen diskutime dhe shfaqje të dokumentarëve ose pamjeve arkivore që lidhen me Luftës së Dytë Botërore. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP | 01.10.2024 | MAS | - | |
| 29 | Podcast: "Heronjtë që na frymëzojnë" | Podcaste ku shkollat të organizojnë biseda me shkrimtarë, historianë, gazetarë, ushtarakë etj., ku të flasin për tema që lidhen me heronj që na frymëzojnë. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP/Shkollat | 01.10.2024 | MAS | - | |
| 30 | Konkurse me ese për ngjarjet e L.II.B me nxënësit e shkollave të mesme | Organizimi i një konkursi me ese me tema historike te L.II.B në bazë shkolle dhe ZVAP-je, me nxënësit e shkollave të mesme. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP | 01.10.2024 | MAS | - | |
| 31 | "Një ditë në ushtri" | ZVAP do të organizojnë në zonat e tyre, vizita të nxënësve në mjediset e reparteve ushtarake ose në Muzeun e Armëve apo edhe në Ministrisë së Mbrojtjes. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP/MM | 01.10.2024 | MAS | - | |
| 32 | Album "Këngë patriotike të luftës së dytë botërore" | Dixhitalizimi melodive, Redaktimi dhe përshtatja e teksteve,Orkestrimet për formacione të ndryshme, Vënia e tyre në funksion dhe të aktivitetit propozuar nga MEKI-i "Disqe Gramofoni" | Ministria e Mbrojtjes | MEKI, Akademia e Shkencave Insituti i Historisë, TVSH | 01.10.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 920,000 | |
| 33 | Konkursi letrar për autorë të rinj me temën: "Qytetet e padukshme" | "Qytetet e padukshme" do të jetë një temë, e cila kërkon të elaborojë qytetin në të gjitha kontekstet e mistereve të tij, për të udhëtuar në kohë, në ngjarjedhe histori që i japin atij dimensionin e kohës.<br>Duke e parë luftën nacional-çlirimtare si një pjesë të rëndësishme të historisë së krijimit të tij, ky konkurs i cili do t'u drejtohet të rinjve, synon jo vetëm nxitjen e kureshtjes ndaj së shkuarës, por dhe motivimin e autorëve të rinj drejt shkrimit. Temat historike gjithnjë kanë qenë pjesë e laboratorit krijues të shkrimtarëve. | QKLL | MEKI,MAS, | 01.10.2024 | QKLL | - | |
| 34 | Botimi i librit "Dhora Leka" ne perkujtim te 100 vjetorit | Botimi I librit në përkujtim të 100 Vjetorit të kompozitores Dhora Leka me të gjitha këngët partizane të kompozuara prej saj<br>Grupi i punës nga QKMBMMFA do të merret me organizimin e aktivitetit të botimit dhe promovimit të librit. | Ministria e Mbrojtjes | Qendra Kulturore e FA | 01.10.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 480,000 | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | Tur koncertor në 12 qarqe Shqipëri Koncerti me albumin patriotik, filmat historikë, hymnet e brigadave | Koncert me albumin e pjesëve patriotike<br>Kolana zanore të filmave më të spikatur që evokojnë periudhën e luftës antifashiste<br>Hymnet e brigadave (dixhitalizimi dhe orkestrimi i tyre enkas për këtë përvjetor) | Ministria e Mbrojtjes | Qendra Kulturore FA, (OSFA/OFFA),Qendër Qark | 11.10.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 2,200,000 | |
| 36 | Disqe gramafoni me muzikë nga filmat shqiptarë të luftës për dhurim në zyra qeveritare dhe ambasada si suvenire për delegacione. | Riprodhimi I Muzikes se filmave shqiptare me tematike lufte realizuar ne disqe gramafoni, per ti shperndare ne ministri, kryeministri e mbasada si dhurata suvenir per delegacione. | MEKI/MM | AQSHF, MM,TKOB etj | 21.10.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit | 3,662,000 | 3,662,000 |
| 37 | Nisma: "Unë Jam Shqiptar" - Promovimi në Rrjete Sociale | •Krijimi i videove: "Unë jam Shqiptar sepse..." ose "Sigurisht që unë jam shqiptar se...", - të rinjtë postojnë video të shkurtra për të nxitur krenarinë kombëtare dhe promovuar kulturën përmes rrjeteve sociale.<br>•Përdorimi i hashtagut #UnëJamShqiptar Challenge për të unifikuar dhe promovuar postimet.<br>•Filmime me "Ambasadorët e Rinj" në terren. | MSHRF,MEKI | MEKI | 01.10.2024-31.11.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit, implementon MEKI | 1,530,000 | 1,530,000 |
| 38 | Ndërveprim me komunitetin për rolin e policisë dhe rëndësinë e 80-vjetorit të çlirimit. | Zyra të hapura në Komisariatet e Policisë, ku oficerët angazhohen me qytetarët dhe diskutojnë rëndësinë e 80-vjetorit të çlirimit dhe rolin e forcave të ligjit, për sigurinë e rendin publik. | Ministria e Brendshme | me Ministrinë e Arsimit | 01.11.2024 | Ministria e Brendshme | - | |
| 39 | Ekspozita historike qe tregopjne historine e luftes per clirimin e vendit | Ekspozita/prezantime që tregojnë historinë e luftës për çlirimin e vendit, duke përfshirë arte-fakte, fotografi a dokumente. Mund të zhvillohen në ambientet e policisë ose në bashkëpunim me muze vendore. | Ministria e Brendshme | me Akademinë e Sigurisë dhe DVP-të | 01.11.2024 | Ministria e Brendshme | - | |
| 40 | Ribotimi i albumit me foto e dokumente arkivore me titull "Rezistenca e popullit shqiptar gjatë Luftës së Dytë Botërore | Perzgjedhja e dokumenteve apo fotove qe nevojiten per plotesim, Botimi dhe prezantimi I botimit ne Panairin e Librit | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave/MM | ë<br>Bashkëpunim DPA me Ministrinë e Mbrojtjes | 01.11.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 3,000,000 | |
| 41 | Ribotimi i përmbledhjes me dokumente me titull "Heronjtë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare" | Perzgjedhja e dokumenteve apo fotove qe nevojiten per plotesim, Botimi dhe prezantimi I botimit ne Panairin e Librit | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave/MM | Bashkëpunim i DPA me Ministrinë e Mbrojtjes | 01.11.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 2,500,000 | |
| 42 | Ekspozitë (lëvizëse) me dokumente arkivore dhe foto nga periudha e Luftes Antifashiste | Përzgjedhja e dokumenteve e fotove<br>Dokumente të ndryshme, Printime. Paraqtije e ekspozites ne qytete te vendit ne data te rendesishme te LANCl<br>Fotografi të personazheve historike të periudhës së Luftës | Ministria e Mbrojtjes/Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave | MM,Bashkinë Tiranë, Durrës, Berat, Përmet | 01.11.2024 | DPA | - | |
| 43 | Konkurs kombëtar "Dokumenti im" për dokumentet personale në kuadër të 80- vjetorit të çlirimit | Përzgjedhja e shkollave, përzgjedhja e nxënësve, vlerësimi I punimeve, shpërndarja e çmimeve | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave | Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve/Drejtoria e Komunikimit (DPA) | 01.11.2024 | DPA-se dhe MAS | - | |
| 44 | Video historike me dokumente arkivore të MEPJ gjatë Luftës dhe Çlirimit të Shqipërisë | Video historike me dokumente arkivore te MEPJ gjate periudhës se Luftës dhe Çlirimit te Shqipërisë, korrespondencat e asaj periudhë etj. te cilat do te pasqyrohen ne te gjithë platformat digjitale te MEPJ dhe përfaqësive diplomatike | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | | 01.11.2024 | MEPJ | - | - |
| 45 | Platformat digjitale | Aktivitet me veteranet ose pasardhësit e tyre dhe Trupin Diplomatik | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | | 01.11.2024 | MEPJ | - | - |
| 46 | Video te shkurtra ne format Reel me familjare te deshmoreve te luftes | Video te shkurtra ne format Reels me familjarë te veteraneve apo dëshmoreve te luftës qe jetojnë jashtë vendit | Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme | | 01.11.2024 | MEPJ | - | - |
| 47 | Ekspozita për Luftën e Dytë Botërore | Krijimi i ekspozitave në bazë shkolle me monumente historike dhe kulturore, kushtuar datave historike dhe dëshmorëve të Luftës Nacional-Çlirimtare. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP | 01.11.2024 | MAS | - | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 48 | Ekspozita historike dhe artistike | Çdo ZVAP do të organizojë hapjen e një ekspozite historike që shfaq artefakte, dokumente, fotografi dhe relike që lidhen me çlirimin e vendit gjatë Luftës së Dytë Botërore ose me foto të vendeve memoriale ushtarake në Shqipëri. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP/ASCAP | 01.11.2024 | MAS | - | - |
| 49 | Panair Kombetar me teme: "Të mësojmë nga historia e brezave" | Organizimi i panaireve në nivel DRAP-i, me punime të nxënësve me temë: "Të mësojmë nga historia e brezave". | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP | 01.11.2024 | MAS | - | - |
| 50 | Festojmë 28-29 Nëntorin | Organizimi i aktiviteteve kulturore-artistike në nivel shkolle dhe qyteti. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | DPAP/Grupi i punës | 01.11.2024 | MAS | - | - |
| 51 | Simpozium me tema/kumtesa që trajtojnë ngjarje të LANÇL | Organizimi i një simpoziumi me rrjetet profesionale të mësuesve të historisë me tema/kumtesa që trajtojnë ngjarje të LANÇL | Ministria e Arsimit dhe Sportit | ASCAP/DPAP | 01.11.2024 | MAS | - | - |
| 52 | Ekspozitë "80-vjetori i çlirimit të Shqipërisë në koleksionet e Bibliotekës Kombëtare" | Ekspozita do të organizohet në mjediset e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë. Ajo do të paraqesë ngjarjen në këndvështrimin e studiuesve shqiptarë e të huaj | BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË | | 25.11.2024 | BIBLIOTEKA KOMBËTARE E SHQIPËRISË | 60,000 | |
| 53 | Takim përkujtimor në kuadër të 80 vjetorit të Çlirimit | Takim me studentë dhe kursantë të Akademisë së Sigurisë | Policia e Shtetit | Akademia e Shkencave Universiteti I Tiranës | 27.11.2024 | Policia e Shtetit | - | - |
| 54 | Koncert gala, vokal, operistik dhe balet nga TKOBAP | Tinguj që sollën lirinë (Korce, Gjirokaster) | TKOBAP | MM | 27.11.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit | 3,686,000 | 3,656,000 |
| 55 | Koncerte gala, vokal, operistik dhe balet nga TKOBAP | Oshëtima e maleve (Tirane, Shkoder) | TKOBAP | MM | 28.11.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit | 1,416,000 | 1,366,000 |
| 56 | Koncerte gala, vokal, operistik dhe balet | Plaga e dhjetë e "Gjergj Elez Alisë" (Gjirokaster) | TKOBAP | MM | 11.05.2024 | TKOBAP | - | |
| 57 | Koncerte gala, vokal, operistik dhe balet nga TKOBAP | Nëntori I yjeve të arta (Fier, Tirane) | TKOBAP | MM | 29.11.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit | 2,476,000 | 2,446,000 |
| 58 | Koncert "Na Bashkon Flamuri" | Na bashkon flamuri, Trupa AP Shqiperi, Ansambli Shota Kosove, AP Maqedonia e Veriut | TKOBAP | | 29.11.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit | 1,632,000 | 1,532,000 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 59 | Realizimi i ceremonive në të gjithë vendin në përkujtim të Dëshmorëve nga radhët e Poliisë të cilët kanë përvjetorët gjatë vitit 2024 | Organizimi i ceremonive në përkujtim të 38 punonjësve që kanë humbur jetën në krye e për shkak të detyrës.Ceremonitë do të organizohen në të gjitha qarqet. | Policia e Shtetit | Prefektura | 01.12.2024 | Policia e Shtetit | 960,000 | |
| 60 | Libri i përbashkët i gjuhës dhe kulturës në shqipe në diasporë niveli II | Libri i përbashkët për promovimin e gjuhës dhe kulturës shqipe në disaporë dhe nxitjen e atdhedashurisë tek shqiptarët jashtë atdheut. | Ministria e Arsimit dhe Sportit | MAS; MASHTI; QBD | | QBD | - | - |
| 61 | Suveniret e 80 vjetorit | Pergatitja e nje sasie suveniresh te cilat perfshijne spila, per 80 vjetorin apo modele te tjera te posacme, "badge" mirenjohje per familjet e pasardhesve te deshmoreve te LANC ne bashkepunim me Shoqaten e Veteraneve dhe DPA-se. Përzgjedhja e imazheve (foto e dokumente), Skanimi, digjitalizimi tyre,Prodhimi I suvenirëve,Ekspozimi tyre | Ministria e Mbrojtjes,Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave,Ministria e Mbrojtjes,Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave | 01.06.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 3,000,000 | |
| 62 | Botimi i Librit 'Dëshmorët e Atdheut' | Botimi i Librit 'Dëshmorët e Atdheut' 10.000 copë | MM,ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE DHE DËSHMORËT E TJERË TË ATDHEUT | MM,ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE DHE DËSHMORËT E TJERË TË ATDHEUT | 01.11.2024 | Ministria e Mbrojtjes | 500,000 | |
| 63 | Muaji i Filmit Shqiptar | Shfaqje filmash te kinematografisë shqiptare me tematikë "Luftën e II Boterore" dhe diskutim mbi problematikat që trajtojnë veprat kinematografike të shfaqura. | **Përfaqësitë Diplomatike**<br><br>Ambasada në Athinë<br>Konsullata në Selanik<br>Ambasada në Ankara<br>Ambasada në Sofje<br>Ambasadë në Pragë<br>Ambasada në Stokholm<br>Ambasada në Zagreb<br>Konsullata në Munih<br>Ambasada në Berlin<br>Ambasada në Lubjanë<br>Misioni në Bruksel<br>Ambasada në Vashavë<br>Misioni në Gjenevë<br>Ambasada në Bernë<br>Ambasada në Abu Dhabi<br>Ambasada në Beograd<br>Ambasada në Shkup<br>Ambasada në Prishtinë<br>Ambasada në Podgoricë<br>Ambasada në Tokio<br>Ambasada në Bukuresht | AQSDHF | 01.11.2024 | Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit | 5,500,000 | 5,500,000 |
| 64 | Ekspozitë e njësuar me foto historike | Ekspozitë e njësuar me foto historike, e cila do të shpërndahet në përfaqësitë me pwrmbajtjen e përgatitur nga DPA | **Përfaqësitë Diplomatike**<br><br>Ambasada në Athinë<br>Konsullata në Selanik<br>Ambasada në Ankara<br>Ambasada në Sofje<br>Ambasadë në Pragë<br>Ambasada në Stokholm<br>Ambasada në Zagreb<br>Konsullata në Munih<br>Ambasada në Berlin<br>Ambasada në Lubjanë<br>Misioni në Bruksel<br>Ambasada në Vashavë<br>Misioni në Gjenevë<br>Ambasada në Bernë<br>Ambasada në Abu Dhabi<br>Ambasada në Beograd<br>Ambasada në Shkup<br>Ambasada në Prishtinë<br>Ambasada në Podgoricë<br>Ambasada në Tokio<br>Ambasada në Bukuresht | DPA | 01.11.2025 | MEPJ | 6,300,000 | |
| | | | | | Buxheti total | | 51,260,000 | 23,220,000 |
| | | | | | Buxheti nga Fondi rezervë I Buxhetit te Shtetit | | 23,220,000 | |
| | | | | | Buxheti aktual i institucioneve | | 28,040,000 | |